



## KONTRATË

### **PËR THEMELIMIN E SHOQËRISË "G.M.A. 2", SH.P.K.**

E lidhur midis palëve

1. Edmond Krliu, i biri i Iseinit, i dt.1957, banues ne Shkup, rruga Marshall Tito Nr.31, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar

2. Fuad Haxhiymeri, i dt. 1964, lindur dhe banues ne Tirane, rruga Qemal Stafa Nr. 78, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Palët e mësipërme, duke qënë të pranishëm, të deklaruar ortakë, ranë dakord që kontratën e themelimit të Shoqërisë së përbashkët ta formulojnë sipas kërkesave të ligjit 7667, datë 28/01/1993, dhe ligjit 7638, datë 19/11/1992 "Për shoqëritë tregtare", dhe vendosën sa më poshtë:

#### **I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1**

Themelohet ndërmjet tyre një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "G.M.A.2", SH.P.K.

##### **Neni 2**

Shoqëria e sipërpërmendur ngrihet sipas ligjit shqiptar dhe e ka selinë e saj në Tiranë, Rruga e Kavajes, Fabrika e Blojes.

##### **Neni 3**

Sipas ligjit shqiptar Shoqëria është një person juridik privat dhe veprimtaria e saj do të ushtrohet në përputhje me aktet e krijimit të saj (akti themelues dhe statuti) si dhe të legjisllacionit shqiptar.

##### **Neni 4**

Shoqëria përgjigjet me pasurinë e saj.  
Në asnjë rast Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e ortakëve.  
Ortakët nuk përgjigjen personalisht për detyrimet e Shoqërisë.  
Shoqëria përgjigjet për detyrimet e saj ndaj shtetit ose ndaj të tretëve brenda kufirit të mjeteve të saj financiare.

##### **Neni 5**



#### Neni 10

Kapitali themeltar nënshkruhet tërësisht dhe është shlyer nga ortakët sipas kuotave që ata zotërojnë në këtë kapital.

### V. ORGANET E SHOQËRISË

#### Neni 11

Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- *Asamblea e Ortakëve,*
- *Administratori.*

Administratori i Shoqërisë emërohet Z. Fuad Haxhiymeri

Asamblea e Ortakëve është organi më i lartë drejtues i Shoqërisë. Ortakët mund të përfaqësohen në mbledhje vetëm sipas ligjit, pra nga ortakë të tjerë ose nga persona përfaqësues me prokurë nga ortaku.

### VI. VEPRIMTARIA DHE FITIMI I SHOQËRISË

#### Neni 12

Shoqëria realizon fitimin me ushtrimin e veprimtarisë së saj të përcaktuar në aktin themelues dhe në statut.

#### Neni 13

Ortakët kanë të drejta mbi fitimin që Shoqëria realizon. Fitimi neto rezulton nga bilanci vjetor i Shoqërisë, i përpiluar në përputhje me statutin e saj dhe legjislacionin shqiptar, mbas pagimit të taksave, tatimeve dhe pagave.

#### Neni 14

Ortakët marrin pjesë në shpërndarjen e fitimit sipas kuotave të tyre në kapitalin social.

#### Neni 15



**Neni 21**

Shoqëria fiton personalitetin juridik me vendimin e rregjistrimit në *Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Tiranë*.

**Neni 22**

Ortakët bien dakord që Z.Fuad Haxhiymeri te autorizohet për paraqitjen dhe regjistrimin e Shoqërisë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Tiranë.

**Neni 23**

Kjo kontratë është e përpiluar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.

**ORTAKËT**

**Edmond KRLIU**

**Fuad HAXHIYMERI**



5747279

**I SHOQËRISË "G.M.A. 2", SH.P.K.**

**I. KRIJIMI, FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI,  
SELIA DHE KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

**Neni 1**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "G.M.A. 2", SH.P.K., me qendër në Tiranë, është krijuar në bazë të kontratës që i bashkangjitet ky statut, të përpiluar dhe të nënshkruar nga:

1. Edmond Krliu, i biri i Iseinit, i dt. 1957, banues në Shkup, rruga Marshall Tito Nr. 31, madhor, me zotësi të plote juridike për të vepruar
2. Fuad Haxhiymeri, i dt. 1964, lindur dhe banues në Tiranë, rruga Qemal Stafa Nr. 78, madhor, me zotësi të plote juridike për të vepruar.

**Neni 2**

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë tregtare në Shqipëri, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe në përputhje me dispozitat e këtij statuti.  
Shoqëria e fiton personalitetin juridik nga dita e regjistrimit të saj.

**Neni 3**

Emërtimi i shoqërisë është "G.M.A. 2", SH.P.K.

**Neni 4**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj ushtrimin e aktivitetit privat në fushën e:

- import-eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të artikujve ushqimorë, bujqësorë blegtoralë, industrialë, të lëndëve të përpunuara dhe të papërpunuara, të bimëve medicinale, farmaceutike e kozmetike, sipas ligjeve në fuqi;
- prodhim dhe tregtim me shumicë e pakicë të makaronave artikujve të tjerë ushqimorë, bujqësorë (si bluarje gruri etj.), blegtoralë e kimikë;
- import-eksport dhe tregtim të paisjeve mekanike, makinerive industriale bujqësore e blegtorale

**Neni 5**

Selia e shoqërisë është në Tiranë, rruga e Kavajes, Fabrika e Blojes, Ajo mund të hapë filiale dhe dege në të gjitha rrethet e vendit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.  
Shoqëria ka vulën e vet me emrin e saj.

## Neni 6

Kohëzgjatja e shoqërisë është përcaktuar për një periudhë mbi 10 vjet, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj. Kjo periudhë mund të shkurtohet në rast se shoqëria priset para kohe.



## II. KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTI, PJESËT E KAPITALIT THEMELTAR.

### Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100000 (njëqindmijë) lekë.

### Neni 8

Kapitali themeltar përbëhet nga kontributi i ortakëve i ndarë si më poshtë:

- Edmond Krliu 50.000 leke = 50% te kapitalit
- Fuad Haxhiymeri 50 000 lekë = 50 % të kapitalit

### Neni 9

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie, në rast ndarje pasurore ndërmjet bashkëshortëve dhe nëpërmjet paraardhësve e pasardhësve.

### Neni 10

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë më miratimin e tërë ortakëve.

### Neni 11

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar gjithmonë duhet të vërtetohet me *Akt - Noterial*.

## III. MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI KOMPETENCA DHE KONTROLI I SHOQËRISË

## Neni 12

Organet e Shoqërise janë;

1. Asambleja e Ortakëve
2. Administratori

Organi më i lartë vendimor i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

Në Asamble marrin pjesë Ortakët me të drejtë vote në përpjestim me kuotën respektive të kapitalit të shoqërise

Asambleja e Ortakëve vendos për bilancin vjetor, për ndryshimet në statut, për rritjen ose paktimin e kapitalit themeltar, për mbylljen e Shoqërisë.

Cdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër. Secili prej tyre mund të përfaqësohet edhe nga një person tjetër.

## Neni 13

Asambleja e Ortakëve mund të jete e Zakonshme ose e Jashtezakonshme.

Asambleja e Zakonshme thirret te pakten një herë në vit pas mbylljes së ushtrimit të vitit financiar. Ajo thirret nga Administratori dhe në mungesë të tij nga eksperti kontabel i autorizuar, në rast se ka të tilla.

Thirrja e Asamblese bëhet me leter rekomande, e cila u dërgohet ortakëve te pakten 15 ditë para datës së mbledhjes. Lajmerimi duhet të përmbajë ditën, vendim të zhvillimit të mbledhjes dhe rendin e ditës..

Vendimet në mbledhjen e zakonshme të Shoqërise merren me shumicën e thjeshtë të votave

. Në Asamble çdo kuotë e kapitalit themeltar përfaqësohet nga një votë.

## Neni 14

Asambleja e Jashtezakonshme thirret kur Administratori i Shoqërise, ose eksperti kontabel e quajne të domozdoshme për interesat e shoqërise. Vendimet në mbledhjen e Jashtezakonshme, merren në unanimitet të votave.

Vendimet për të cilat kërkohet unanimitet janë:

- Ndryshimet në statut,
- Zgjatjen e veprimtarisë së Shoqërisë,
- Mbylljen e aktivitetit të Shoqërisë.

## Neni 15

Administrator i Shoqërisë është Z. Fuad Haxhiymeri

Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë dhe në emër të saj, nëpërmjet kompetencave që i janë përcaktuar në këtë statut. Administratori shkarkohet me vendim të ortakëve që përfaqësojnë me tepër se gjysmën e pjesës së kapitalit themeltar.. Emërimi i tij bëhet për 3 (tre) vjet financiarë.

## Neni 16



Administratori është përgjegjës individualisht ose solidarisht sipas rastit, ndaj shoqërisë apo të tretëve, për shkelje të ligjeve, të dispozitave të këtij statuti apo për faje gjatë administrimit të shoqërisë.

#### **Neni 17**

Disa nga kompetencat që i jepen administratorit janë:

- Të sigurojë drejtimin e mirë të shoqërisë,
  - Të administrojë pasurinë e shoqërisë,
  - Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët,
  - Të përfaqësojë shoqërinë para organeve gjyqësore ose të autorizojë persona të tjerë kompetentë.
- Të kryejë veprime juridike me të tretët, në emër dhe për llogari të shoqërisë, të tilla si: lidhje kontratash, çelje kredish, kryerje veprimesh bankare etj brenda limitit që i lejojnë ortakët.

#### **Neni 18**

Kontrolli i shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabël i cili emërohet dhe shkarkohet nga tërë ortakët.

### **IV. VITI FINANCIAR DHE LLOGARITË VJETORE**

#### **Neni 19**

Cdo vit financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përgjashtimisht viti i parë financiar fillon ditën e regjistrimit si person juridik.

#### **Neni 20**

Llogaritë vjetore, inventari, raporti mbi veprimtarinë e vitit financiar të hartuara nga administratori, nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga tërë ortakët brenda një afati 6 mujor nga dita e mbylljes së vitit financiar.

#### **Neni 21**

Bilanci vjetor i veprimtarisë së shoqërisë nxirret brenda 31 Marsit të vitit pasardhës.

#### **Neni 22**

Tërë ortakët vendosin për qëllimin e përdorimit të fitimeve neto të realizuara nga veprimtaria e shoqërisë, mbasi zbriten të gjitha shpenzimet e kryera; ato mund të përdoren për: investime, nxitje ekonomike, reklama tregtare etj.



### **Neni 23**

Shoqëria ka të drejtën e përdorimit lirisht të fitimeve dhe të disponimit lirisht të pasurisë së saj në përputhje me qëllimin e objektit të veprimtarisë që kryen.

### **Neni 24**

Detyrimet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë ajo i mbulon nga fondi rezervë ose nga shumat suplementare.

### **Neni 25**

Shoqëria gëzon të gjitha të drejtat dhe mbrojtjen e pasurive të saj nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

## **V. PUNËSIMET NË SHOQËRI**

### **Neni 26**

Për punonjësit që do të punësohen, mardhëniet juridike midis shoqërisë dhe të punësuarve do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punës në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

### **Neni 27**

Shoqëria merr përsipër të derdhë rregullisht të gjitha detyrimet, gjithashtu dhe kontributet për sigurimin e të punësuarve të saj në organet kompetente përkatëse, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

## **VI. PRISHJA E SHOQËRISË, LIKUIDIMI**

### **Neni 28**

Shoqëria priset para kohe kur:

- Aktiviteti ekonomik i saj për disa vjet rradhazi është me humbje.
- Për arsye të parashikuara me ligj.
- Në çdo rast tjetër me vendim të tërë ortakëve.

### **Neni 29**

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e marrjes së vendimit për prishjen e saj. Për kryerjen e këtij procesi, të tërë ortakët emërojnë një ose dy likuidatorë, të cilët i paraqesin raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivit të shoqërisë.



## VII. KUSHTET E TJERA

### Neni 30

Të gjitha vendimet e tërë ortakëve regjistrohen në libër të vecantë që mbahet në selinë e shoqërisë.

### Neni 31

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent për zgjidhjen e tyre është *Gjykata e Shkalles së Parë, Tiranë*.

### Neni 32

Ky statut është hartuar në kater kopje ne gjuhen shqipe.

## ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË "G.M.A. 2" SH.P.K.

Edmond KRLIU

Fuad HAXHIYMERI

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE  
Nr. 44857 Rep  
Nr. / Kol